



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.74

20 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.9742
datë 28.5.2007

Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë.....

Faqe
2213

Ligj nr.9743
datë 28.5.2007

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998
“Për urbanistikën”, të ndryshuar.....

2220

LIGJ
Nr.9742, datë 28.5.2007

PËR TRANSMETIMET NUMERIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është të përcaktojë një kuadër rregullues për hyrjen e transmetimit numerik në Republikën e Shqipërisë. Brenda kuadrit të përcaktuar nga ky ligj, operatorët për programet dhe operatorët e rrjetit (multiplekseve) lejohen të transmetojnë programe dhe të ndërtojnë rrjete transmetimi në rrugë numerike.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Transmetim” është emetimi i parë me transmetues tokësor, me kabllo ose satelit, në formë të koduar apo të pakoduar, i shërbimeve programore radio dhe/ose televizive, që i drejtohen publikut në përgjithësi.

2. “Transmetime numerike televizive tokësore” janë sistemet numerike televizive në shërbimin e transmetimit numerik tokësor të përshkruara në Rekomandimin ITU-R BT.1306 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve. Transmetimi numerik video tokësor (DVB-T) është sistemi në shërbimin tokësor, i përcaktuar në Rekomandimin ITU-R BT.1306 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve si “Sistemi Numerik B”.

3. “Transmetimi numerik audio tokësor (T-DAB)” është sistemi në shërbimin tokësor, i përcaktuar në Rekomandimin ITU-R BS.1114 të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve si “Sistemi Numerik A”. DVB-H është sistem transmetimi numerik mobil.

4. “Transmetimi numerik satelitor” është transmetimi i programeve radio e televizive të mbështetura në platforma numerike satelitore.

5. “Rrjet transmetimi tokësor” është tërësia e stacioneve transmetuese tokësore, që mbulon një hapësirë të caktuar (zona e mbulimit) me sinjale të njëjta e të njëkohshme.

6. “Rrjet numerik tokësor me frekuencë të vetme” është një rrjet stacionesh transmetuese të sinkronizuara, që emetojnë sinjale identike në të njëjtin kanal radiofrekuence për të mbuluar një hapësirë të dhënë.

7. “Rrjet numerik tokësor me shumë frekuenca” është një rrjet stacionesh transmetuese të sinkronizuara, që emetojnë sinjale identike në kanale të ndryshme radiofrekuence për të mbuluar një hapësirë të dhënë.

8. “Operator rrjeti” është personi juridik, i cili ofron rrjetin e transmetimit ose një shërbim transmetimi për publikun.

9. “Operator i platformës satelitore numerike (operator satelitor)” është personi juridik, i cili u ofron shërbime operatorëve të programeve nëpërmjet platformave satelitore.

10. “Program” është tërësia e emisioneve dhe elementeve të tjera të një shërbimi radioteleviziv, e destinuar për publikun.

11. “Ritransmetim” është marrja dhe transmetimi i njëkohshëm dhe i pandryshuar i programeve radiotelevizive.

12. “Operator për programet” është personi juridik, i cili ofron programe radiotelevizive për

publikun dhe ka përgjegjësinë ligjore dhe editoriale për përmbajtjen e tyre.

13. “Radiofrekuencat për shërbimet “pikë më pikë”, fikse dhe të lëvizshme të operatorëve radio e televizivë” janë brezat e frekuencave të caktuara për lidhjen e studiove me pajisjet transmetuese. Frekuencat për këto shërbime administrohen nga ERT-ja.

Neni 3

Licencat për ndërtim e shfrytëzim rrjetesh numerike tokësore

1. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit jep licenca për ndërtim dhe shfrytëzim rrjetesh numerike tokësore të transmetimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe kërkesat e aplikantit.

2. Rrjetet numerike tokësore shfrytëzojnë vetëm frekuencat e përcaktuara për përdorim numerik. Shpallja e frekuencave të lira për ndërtim rrjetesh numerike tokësore dhe zonave përkatëse të mbulimit bëhet nga KKRT-ja, në përputhje me disponibilitetin dhe ecurinë e lirit të spektrit nga transmetimet analoge.

3. Licenca për rrjetet numerike tokësore të transmetimit radioteleviziv vlen si leje për instalimin, mirëmbajtjen dhe operimin e pajisjeve teknike të një rrjeti numerik tokësor radio dhe/ose televiziv. Në licencë përcaktohen, përveç kushteve teknike për të realizuar transmetimin, edhe të drejtat e detyrimit e subjektit të licencuar. KKRT-ja përgatit rregulloren dhe procedurat për këtë qëllim.

4. Licencat për rrjetet numerike tokësore janë:

a) kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak se 80 për qind e territorit të banuar të vendit, bazuar mbi të dhënat më të fundit të INSTAT-it;

b) rajonale, për mbulim deri në 4 qarqe me vazhdimësi gjeografike; dhe

c) lokale, për mbulimin e një qarku.

5. KKRT-ja përcakton frekuencat, fuqinë, vendndodhjen dhe zonën për të cilat jepen licencat për ndërtimin e rrjeteve numerike tokësore, në përputhje me Planin e Frekuencave, të adoptuar nga Konferenca Rajonale e Radiokomunikacioneve (GE06), Gjenevë 2006.

6. Tipologjia dhe karakteristikat e rrjeteve numerike tokësore për mbulimin e territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal radioteleviziv përcaktohen nga KKRT-ja në përshtatje me veçoritë territoriale dhe ndarjen administrative të vendit, në koordinim me vendet fqinje dhe në përputhje me karakteristikat teknike të përcaktuara në Aneksin 2 të “Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikimit për planifikimin e shërbimit numerik të transmetimit tokësor në pjesët e rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06)”.

7. Në rastet kur, në funksion të zbatimit të Planit të Frekuencave, të koordinuar edhe me vendet fqinje, për ndërtimin e një rrjeti numerik tokësor kërkohet të përdoret një frekuencë e akorduar një operatori të licencuar për transmetime analoge, KKRT-ja i cakton operatorit analog një frekuencë tjetër për të mbuluar të njëjtën zonë. Shpenzimet për të realizuar ndryshimin e frekuencave përballohen nga KKRT-ja.

Në kushtet e kufizimeve buxhetore KKRT-ja, për mbulimin e shpenzimeve, mund t’i kërkojë financime përfituesit të licencës, si shfrytëzues i rrjetit numerik tokësor, në një masë të arsyeshme, me pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 4

Procedura e licencimit për operator rrjeti

1. Aplikuesit për licencë rrjeti, të pajisur ose jo me licencë për transmetim analog tokësor apo satelitor, që dëshirojnë të ndërtojnë një rrjet numerik, duhet të marrin pjesë në procesin e konkurrimit, të shpallur nga KKRT-ja, detajet e të cilit përcaktohen nga KKRT-ja, në përputhje me një rregullore, që miratohet paraprakisht për këtë qëllim. Në vlerësimin e aplikimeve të marra janë përparësore kriteret e mëposhtme:

a) cilësia e zgjidhjeve teknike, përfshirë shkallën e fleksibilitetit që zgjidhjet e caktuara u ofrojnë përdoruesve në lidhje me zgjedhjen e shërbimeve. Në këtë kuadër, rëndësi duhet t’u kushtohet, mes të tjerave, zgjedhjes së standardeve joekskluzive, aty ku është teknikisht e mundur, për Ndërfaqen e Programeve Aplikative (API) dhe sistemet e kontrollit të aksesit;

b) planet për investim dhe zhvillim të rrjetit, përfshirë shitjen dhe disponueshmërinë e dekoderëve, ritmin e zhvillimit dhe koston për publikun e gjerë;

c) shërbimet që dëshiron të ofrojë aplikuesi. Rëndësi do t'u kushtohet ofertave të ndryshme e të larmishme televizive për grupe të ndryshme të shikuesve. Kjo vlen si për tipat e ndryshëm të përmbajtjes së programeve, ashtu edhe për marrëdhënien midis kanaleve televizive falas dhe atyre me pagesë.

Operatorët e licencuar për transmetime analoge radio e televizive janë të detyruar që programin analog ta transmetojnë në mënyrë të njëkohshme në njërin nga kanalet e rrjetit të tyre numerik gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, derisa përqindja e marrësve analogë të arrijë nën 10 për qind të totalit të marrësve brenda zonës së licencimit.

KKRT-ja përcakton kriteret në lidhje me tipologjinë e programeve në një rrjet.

2. RTSH-ja gëzon të drejtën të ndërtojë dy rrjete numerike tokësore kombëtare, duke përdorur frekuencat e Planit Numerik, që do t'i përcaktohen nga KKRT-ja. Transmetimet analoge të RTSH-së do të vazhdojnë gjatë gjithë periudhës së tranzicionit.

3. Licencimi i transmetimeve radio numerike (T-DAB) realizohet në mënyrë të ngjashme me licencimin e transmetimeve televizive numerike.

Neni 5

Licencat për transmetim programesh radio e televizive

1. Licenca për transmetim programesh radiotevizive i jep personit juridik, operator programesh, të drejtën për të transmetuar një program ose një paketë programesh radio dhe/ose televizive. Programet licencohen një nga një nga KKRT-ja në çastin e licencimit të rrjetit numerik ose në çdo çast të mëvonshëm. Në licencën për transmetim programesh radiotevizive përcaktohen, përveç kushteve për të realizuar programet, edhe të drejtat e detyrimet e subjektit të licencuar. KKRT-ja përgatit rregulloren dhe procedurat përkatëse.

2. Programet radiotevizive të operatorëve analogë tokësorë apo satelitorë të licencuar gëzojnë licencë programi, sipas kuptimit të këtij neni, për periudhën e mbetur të licencimit si operatorë analogë.

3. KKRT-ja u jep licenca për transmetim programesh aplikuesve, të cilët kërkojnë t'i transmetojnë programet e tyre përmes platformës së rrjetit tokësor ose satelitor, sipas një marrëveshjeje me operatorët e rrjeteve përkatëse. Licenca jepet me kusht që programet të përmbushin standardet programore, të përcaktuara në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të rrjetit

1.

Mbajtësit e licencave të rrjeteve dhe të licencuarit për platforma numerike satelitore janë të detyruar të sigurojnë që të paktën 50 për qind e shërbimeve të tyre transmetuese numerike t'u ofrohen përdoruesve pa pagesë. RTSH-ja i transmeton pa pagesë të gjitha programet e veta në rrjetin numerik tokësor dhe satelitor.

2. KKRT-ja siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen operatorëve të programeve nga operatorët e rrjeteve të bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese. Për sistemet e aksesit të kushtëzuar, ndërfaqet e programeve aplikative dhe guidave programore elektronike, KKRT-ja zbaton parimet e përcaktuara në Direktivën e Bashkimit Europian të 7 marsit 2002 (*Access Directive*).

3. Operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve numerike tokësore të transmetimit sigurojnë që programet që transmetojnë të respektojnë rregullat e etikës dhe të kriptimit e kodimit kur i dedikohen publikut të grupmoshave specifike.

Neni 7

Leja për frekuencat për shërbimet "pikë më pikë"

Leja për frekuencat për shërbimet “pikë më pikë” të operatorëve të licencuar për ndërtimin e rrjeteve për transmetime radio e televizive numerike tokësore dhe për lidhje satelitore jepet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, bazuar në Planin e Frekuencave të Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në marrëveshjen që lidhet midis ERT-së dhe KKRT-së.

Neni 8

Tarifat

Pagesat për licencën e rrjetit numerik tokësor, licencën e rrjetit numerik satelitor dhe licencën për ofrimin e programeve të mbështetura në rrjete numerike përcaktohen nga KKRT-ja, bazuar në kriteret e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të subjekteve, duke mbajtur parasysh si pagesat për llojet e tjera të transmetimit, ashtu edhe tendencën e tregut.

Taksat për frekuencat e shërbimit të transmetimeve radiotevizive numerike janë ato të përcaktuara nga ligji nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 9

Standardizimi dhe ndërfunksionimi i shërbimeve numerike interaktive të transmetimit

Operatorët e rrjeteve numerike tokësore dhe operatorët e rrjeteve satelitore u ofrojnë klientëve dekoderë të aftë të marrin të gjithë spektrin e frekuencave dhe vënë në funksionim guida elektronike të programeve, si dhe ndërfaqe të programeve aplikative, në përputhje me standardet e ETSI-së (Instituti European i Standardeve të Telekomunikacioneve).

Neni 10

Kohëzgjatja e licencës

Licencat kombëtare për transmetimet numerike tokësore kanë një kohëzgjatje prej 10 vjetësh. Licencat rajonale dhe lokale për transmetimet numerike tokësore kanë kohëzgjatje prej 8 vjetësh.

Neni 11

Rezerva kulturore

Programet e licencuara për të transmetuar në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet që brenda vitit 2015 të transmetojnë në mënyrë të përshkallëzuar të paktën 50 për qind të të gjithë programit vepra audiovizuale europiane.

Neni 12

Identifikimi i operatorëve

Operatorët e programeve numerike tokësore dhe operatorët kabllorë janë të detyruar të përdorin shenjat dalluese identifikuese përkatëse për rrjetin në tërësi, si dhe për programin në veçanti.

Neni 13

Pluralizmi në median audiovizuale

1. Një person juridik nuk mund të ketë më shumë se një licencë për një rrjet numerik tokësor. Një person fizik, që ka interesa ekonomike ose është në pozitë vendimmarrëse në një person juridik që ka licencë për transmetim numerik tokësor, nuk mund të ketë interesa ekonomike ose të jetë në pozitë vendimmarrëse në një person tjetër juridik që ka një licencë tjetër numerike tokësore.

2. Një operator rrjeti ka të drejtë të pajiset me licencë për transmetimin e një programi radioteviziv dhe anasjelltas.

3. Gjatë periudhës të parashikuar nga ky ligj, një operator analog, kombëtar ose rajonal, mund të marrë një tjetër licencë si operator rrjeti ose programesh.

4. Asnjë operator i licencuar në bazë të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ose në bazë të këtij ligji nuk mund të zotërojë më shumë se 30 për qind të tregut të reklamave në tregun audiovizual.

5. Pronësia në personat juridikë që gëzojnë një licencë për operator rrjeti ose operator programesh respekton kriteret e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Për marrjen e vendimit përkatës në zbatim të pikave 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni, KKRT-ja merr paraprakisht mendimin e Autoritetit të Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës, në çdo rast që verifikon lindjen e një situate, për të cilën bëjnë fjalë pikat 2, 3 dhe 5 të këtij neni, njofton KKRT-në, e cila vendos pezullimin ose heqjen e licencës. Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës është i detyrueshëm për KKRT-në.

Neni 14

KKRT-ja aplikon, sipas radhës, sanksionet e parashikuara nga neni 137 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për operatorët që:

- a) nuk respektojnë zonën e tyre të licencimit;
- b) aplikojnë kriterë diskriminuesë, jotransparente dhe jo të barabarta për operatorët e programeve që kërkojnë të mbështeten në rrjetet e tyre numerike;
- c) ndryshojnë, edhe në mënyrë kumulative, të paktën 25 për qind të pronësisë së kapitaleve të tyre;
- ç) nuk respektojnë kushtet e licencës.

Këto sanksione zbatohen ndaj subjektit përgjegjës për shkeljen e kriterëve të mësipërme.

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 15

KKRT-ja mund të vazhdojë të japë licenca për transmetime analoge, kombëtare ose lokale, në bazë të ligjit 8410 datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me afat deri më 31.12.2012.

Përveç dispozitave specifike të këtij ligji, ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vazhdon të rregullojë të gjitha veprimtaritë transmetuese në Republikën e Shqipërisë.

Ngarkohet KKRT-ja që në akordimin e licencave për transmetimet numerike të vendosë rregulla për të respektuar interesat e abonentëve të transmetuesve numerikë ekzistues në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për një periudhë tranzitore deri në 12 muaj.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shtojca 1

KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR OPERATORË RRJETI PËR TRANSMETIME RADIOTELEVIZIVE NUMERIKE

1. Mbulimi me sinjal tokësor numerik

1.1. Mbajtësi i licencës për transmetim televiziv numerik kombëtar duhet të realizojë mbulimin e jo më pak se 80 për qind të territorit të banuar të vendit, bazuar mbi të dhënat më të fundit të INSTAT-it.

1.2. Mbajtësi i licencës për transmetim radioteleviziv rajonal ose vendor është i detyruar të realizojë mbulimin e zonës së caktuar në licencë, në përputhje me normat teknike të transmetimit.

2. Kushtet financiare për dhënie e licencës

2.1. Për transmetimet radiotelevizive numerike në shkallë kombëtare, licenca u jepet vetëm subjekteve që kanë kapital të deklaruar dhe të nënshkruar në masën:

- jo më pak se 1 miliard lekë.

2.2. Për transmetimet radiotelevizive numerike vendore:

a) në një zonë licencimi vendore, licenca u jepet vetëm subjekteve që kanë kapital të vërtetuar në masën:

- jo më pak se 100 milionë lekë për transmetimet televizive;

b) në një zonë licencimi rajonale, licenca u jepet vetëm subjekteve që kanë kapital të vërtetuar në masën:

- jo më pak se 400 milionë lekë.

3. Pagesat për licencën

3.1.1. Pagesat për marrjen e licencës si operator rrjeti

Pagesa për marrjen e licencës paguhet vetëm një herë. Ajo përcaktohet nga ofertat e pjesëmarrësve në garën e shpallur nga KKRT-ja për licencimin e një rrjeti kombëtar, rajonal ose vendor. Ofertat përcaktohen në një rregullore të posaçme të miratuar nga KKRT-ja për këtë qëllim.

3.1.2. Pagesat për marrjen e licencës si operator programesh

Pagesa për marrjen e licencës paguhet vetëm një herë. Masa e pagesës përcaktohet nga KKRT-ja.

3.2. Pagesat vjetore për licencën

Pagesat vjetore për të gjitha kategoritë e licencave përcaktohen nga KKRT-ja. Kriteri bazë për përcaktimin e pagesave vjetore të operatorëve të rrjetit dhe të operatorëve të programeve, kombëtarë, rajonalë dhe vendorë, është mbulimi i shpenzimeve vjetore të veprimtarisë së organit rregullator (KKRT).

4. Kohëzgjatja e programeve

Licencat për operatorë programesh kombëtarë jepen për një kohëzgjatje ditore të programeve jo më pak se 16 orë në ditë.

Licencat për operatorë programesh rajonalë jepen për një kohëzgjatje ditore të programeve jo më pak se 12 orë në ditë.

Licencat për operatorë programesh vendorë jepen për një kohëzgjatje ditore të programeve jo më pak se 8 orë në ditë.

5. Të licencuarit për transmetime radiotelevizive kombëtare dhe vendore, në lajmet dhe emisionet që transmetojnë, faktet dhe ngjarjet t'i paraqesin në mënyrë të drejtë e të paanshme, për të nxitur formimin e lirë të mendimeve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare.

6. Aftësia e stafit

Të licencuarit për transmetime radiotelevizive numerike kombëtare, në dokumentacionin e aplikimit përfshijnë dhe të dhëna për 7 anëtarët e bordit drejtues, si dhe CV-të e tyre. Anëtarët e bordit drejtues duhet të jenë personalitete të shquara në fushën e gazetarisë, të menaxhimit, të drejtësisë, të financave e teknikës, nga të cilët jo më shumë se tre mund të jenë të punësuar pranë subjektit aplikues.

Të licencuarit për transmetime radiotelevizive numerike rajonale e vendore, në dokumentacionin e aplikimit përfshijnë dhe të dhëna për 5 anëtarët e bordit drejtues, si dhe CV-të e tyre. Anëtarët e bordit drejtues duhet të jenë personalitete të shquara në fushën e gazetarisë, të menaxhimit, të drejtësisë, të financave e teknikës, nga të cilët jo më shumë se dy mund të jenë të punësuar pranë subjektit aplikues.

Të licencuarit si operator rrjeti për transmetime televizive kombëtare dhe vendore duhet të vërtetojnë që në stafin e tyre kanë rekrutuar punonjës që janë teknikisht e profesionalisht të aftë për të ndërtuar, mirëmbajtur e shfrytëzuar pajisjet e nevojshme për transmetime radiotelevizive.

7. Kushtet teknike

Bazat teknike për ndërtimin e rrjeteve numerike tokësore do të jenë në përputhje me përcaktimet që jepen në Kapitullin 3 të Aneksit 2 të Akteve Finale të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve për planifikimin e transmetimeve numerike tokësore në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06), Gjenevë 15 maj-16 qershor 2006.

Pajisjet e prodhimit e transmetimit radioteleviziv, për të ofruar për publikun një shërbim të pranueshëm e pa shqetësime, duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve e normave teknike në prodhim dhe transmetim, bazuar në rekomandimet e organizatave të specializuara ndërkombëtare.

8. Shfrytëzimi i spektrit të frekuencave

Frekuencat e kanaleve të caktuara për operatorët radiotelevizivë nuk jepen për përdorim ekskluziv. Përdorimi i tyre kufizohet në zonat e mbulimit, sipas tabelës, e cila është pjesë përbërëse e licencës. Nuk lejohet përdorimi i frekuencave dhe kanaleve që nuk përfshihen në licencë.

Operatorët radiotelevizivë, sipas nevojave të shtrirjes së rrjetit të tyre, kanë të drejtë t'i kërkojnë KKRT-së frekuenca (kanale) të tjera shtesë për të përmirësuar mbulimin e territorit dhe popullsisë, të përcaktuara në kushtet e licencës.

9. Detyrimet kundrejt publikut

Transmetuesit e programeve radio dhe televizive, kombëtare apo vendore, janë të detyruar të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ata transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me shëndetësinë, fatkeqësi natyrore dhe rendin.

10. Koha e fillimit të transmetimit

Të licencuarit si operatorë rrjeti për transmetime radiotelevizive numerike kombëtare janë të detyruar të fillojnë transmetimet jo më vonë se 1,5 vjet nga data e marrjes së licencës.

Të licencuarit si operatorë rrjeti për transmetime radiotelevizive numerike rajonale e vendore janë të detyruar të fillojnë transmetimet përkatësisht:

- për transmetime rajonale, 270 ditë nga data e marrjes së licencës;
- për transmetime vendore, 180 ditë nga data e marrjes së licencës.

11. Inspektimi teknik

Transmetimi në bazë të licencës së dhënë fillon vetëm pas inspektimit teknik të projektit dhe të pajisjeve nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i cili konfirmon zyrtarisht me shkrim përputhjen e kushteve të licencës me ato të realizuara faktikisht.

12. Ndryshimet e kushteve të licencës

KKRT-ja ka të drejtë të bëjë ndryshime në kushtet dhe detyrimet e licencës kur ligjet e shtetit shqiptar apo kushtet e zhvillimit të këtij shërbimi e kërkojnë një gjë të tillë. Për çdo ndryshim, KKRT-ja merr në konsideratë edhe vërejtjet e subjektit të licencuar.

13. Pagesa për frekuencat

Të licencuarit që do të fitojnë licencën si operator rrjeti për transmetime televizive, kombëtare apo vendore, për përdorimin e frekuencave do të paguajnë vetëm taksën, sipas ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë".

LIGJ

Nr.9743, datë 28.5.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 "PËR URBANISTIKËN", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9 paragrafi i parafundit ndryshohet si më poshtë:

"- Lejet e ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore kombëtare."

Neni 2

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

KRRT-ja e Bashkisë së Tiranës përbëhet nga 9 anëtarë. Anëtarët e KRRT-së së Bashkisë së Tiranës janë:

- Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Kryetar i KRRT-së;
- 3 anëtarë, me propozimin e shumicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 3 anëtarë, me propozimin e pakicës së Këshillit Bashkiak të Tiranës;
- 1 anëtar, përfaqësues i ministrit përgjegjës për planifikimin urban;
- 1 anëtar, që zgjidhet me 3/5 e votave të të gjithë Këshillit Bashkiak të Tiranës.”.

Neni 4

Në nenin 21, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vendimet e KRRT-së Tiranë merren me jo më pak se pesë vota pro, përveç rasteve të parashikuara në nenin 20 pika 2 shkronjat “c” dhe “dh”, për të cilat vendimet merren me jo më pak se 6 vota pro.”.

Neni 5

Në fund të nenit 38 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Kërkesat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen në rastin e ndërtimeve të infrastrukturës rrugore publike.”.

Neni 6

Në nenin 45 fjalia e parafundit ndryshohet si më poshtë:

“Kërkesa për leje ndërtimi bëhet sipas formularëve 3 dhe 3/1, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i kërkesës për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës.”.

Neni 7

Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Leja e ndërtimit i jepet kërkuarit të saj sipas formularit nr.4, pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore. Formulari i lejes së ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore miratohet nga ministri përgjegjës.”.

2. Fjalia e tretë shfuqizohet.

3. Fjalia e parafundit ndryshohet si më poshtë:

“Formulari i lejes plotësohet nga sekretari i KRRT-së/KRRTSRH-së.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 20.6.2007
Doli nga shtypi më 20.6.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë